



VENDIMI I PRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 4 qershor 2020

Nr. i lëndës: 2019-01

G.T.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 4 qershor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Kjo ankesa është regjistruar më 1 gusht 2019.
2. Ankuesja ka kërkuar që identiteti i saj mos të bëhet publik. Duke shqyrtuar çështjen, posaçërisht rrethanat e lëndës, Paneli është i bindur që kjo kërkesë duhet të pranohet.
3. Me letrën e datës 5 gusht 2019, Paneli informoi EULEX-in Kosovë ("Misionin") se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.
4. Më 16 tetor 2019, Paneli kërkoi nga ankuesja të siguronte informata shtesë në lidhje me ankesën.
5. Më 29 tetor 2019, ankuesja paraqiti informata shtesë.

6. Më 26 nëntor 2019, Paneli i dërgoi Misionit një Deklaratë të Pretendimeve dhe Pyetjeve, duke kërkuar nga Misioni përgjigje me shkrim dhe vërejtje rreth ankesës jo më vonë se deri më datën 26 janar 2020.
7. Paneli pranoi vërejtjet e shefit të Misionit më 18 shkurt 2020.
8. Më letrën e datës 19 shkurt 2020, ankuesja u ftua të përgjigjej në parashtresat e Misionit deri më datën 20 mars 2020, nëse ajo do të dëshironte ta bënte këtë.
9. Ankuesja dorëzoi vërejtjet e saj rreth parashtresave të Misionit më 12 mars 2020.

II. FAKTET

10. Faktet e lëndës, siç paraqiten nga palët, dhe siç duket nga dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si më poshtë:
11. Ankuesja mori një thirrje nga një gjykatë në Kosovë për t'u paraqitur si dëshmitare në një seancë penale që po zhvillohej diku në vitin 2019 në një gjykatë në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm "Serbia"). Këto procedura penale kishin të bënin me krime të rënda që dyshohej se ishin kryer gjatë konfliktit në Kosovë në vitet 1998-99.
12. Pak kohë pasi ankuesja kishte pranuar thirrjen dhe para datës së caktuar të seancës dëgjimore, Misioni kontaktoi ankuesen në lidhje me thirrjen dhe udhëtimin nga vendbanimi i saj në Kosovë për në Serbi për të dëshmuar në seancë.
13. Misioni më pas organizoi transportin dhe shoqëroi ankuesen në Serbi diku në vitin 2019.
14. Misioni gjithashtu përzgjedhi akomodim tjetër në Serbi për ankuesen kur u gjet se akomodimi i ofruar nga autoritetet serbe ishte i papërshtatshëm. Misioni kishte sjellë së bashku një mjek shqipfolës, pasi këto masa paraprake i kishte parë të nevojshme.
15. Sipas ankueses, ajo ishte kërcënuar dhe frikësuar përderisa ishte në Serbi, dhe më pas edhe në shtëpinë e familjes së saj në Kosovë, si rezultat i dëshmisë së saj në Serbi. Ankuesja vuan nga trauma si rezultat i frikësimit. Hollësitë se çfarë përbëjnë këto kërcënime dhe veprimet e frikësimit përshkruhen më poshtë.

III. ANKESAT

16. Ankuesja pretendon se Misioni premtoi se do ta mbronte atë, por nuk ka arritur ta bëjë këtë. Ajo u frikësua në gjykatën në Serbi dhe mori kërcënime anonime përderisa ishte në shtëpi në Kosovë.
17. Ankuesja pohon se Misioni ka shkelur të drejtat e saj të njeriut duke e ekspozuar atë ndaj këtij frikësimi. Ankuesja pohon se ky frikësim i ka shkaktuar stres dhe traumë. Ajo pretendon se shëndeti i saj dhe mirëqenia mendore kanë pësuar rëndë nga kjo përvojë dhe se për këtë shkak është duke marrë kujdes mjekësor.
18. Ankuesi pretendon shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa"), pa specifikuar ndonjë nen të veçantë të Konventës. Paneli vëren se, në përputhje me praktikën gjyqësore të vendosur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Gjykata"), një ankesë karakterizohet nga faktet, dhe është roli i Gjykatës - ose, në rastin konkret, i Panelit - për të karakterizuar ligjin siç aplikohet për faktet (parimi i *jura novit*

curia, shih p.sh. *Şifeerife Yiğit kundër Turqisë* [GC], nr. 3976/05, 2 nëntor 2010, par. 52). Paneli konsideron se pretendimet faktike të paraqitura nga ankuesja kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut të garantuara në nenet e mëposhtme të Konventës: Neni 3 (ndalimi i torturës, dënimit ose trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës) dhe neni 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare).

19. Në këto dispozita të Konventës thuhet si më poshtë:

Neni 3 Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese".

Neni 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

IV. PARASHITESAT E PALËVE

Ankuesja

20. Ankuesja pohon se kur Misioni kishte kontaktuar me të, zyrtarët e Misionit "na thanë [ankueses dhe dëshmitarëve të tjerë] të shkonim në një Gjykatë për të ofruar deklaratat për një rast të [e redaktuar nga Paneli]. EULEX-i premtoi shumë siguri, por ajo që ndodhi ishte e kundërta". Ankuesja pretendon se Misioni premtoi të garantojë sigurinë e saj gjatë udhëtimit në Serbi. Nga parashitesat e ankueses është e qartë se ajo kishte kuptuar që Misioni do të ishte përgjegjës për sigurinë e saj.
21. Ankuesja pretendon se kishte pranuar që të shkonte dhe dëshmonte vetëm për shkak të garancisë rreth sigurisë nga ana e Misionit. Duke iu përgjigjur vërejtjes së Misionit se e kishte njoftuar ankuesen se autoritetet serbe do të ishin përgjegjës për sigurinë, ankuesja deklaroi se nëse ajo do t'a kishte ditur që autoritetet serbe do të ishin përgjegjës për sigurinë e saj, ajo nuk do të pranonte të udhëtonte në gjykatë në Serbi, pasi ajo nuk u beson autoriteteve serbe.
22. Sa i përket frikësimit, ankuesja pretendon se ajo ishte kërcënuar dy herë me pasoja për familjen e saj përderisa po jepte deklaratën e dëshmitarit në gjykatë në Serbi. Në një moment kur ishte në gjykatë, ankuesja pretendon se disa persona nxituan drejt saj dhe dëshmitarëve të tjerë, duke folur në gjuhën serbe që ajo nuk mund t'i kuptonte.
23. Ajo pretendon se zyrtarët e Misionit ishin dëshmitarë të ngjarjeve, por nuk reagues. Ankuesja pretendon se, si rezultat i këtij frikësimi, ajo kërkoi kujdes mjekësor gjatë procesit për të përballuar stresin.
24. Pas kthimit të saj në Kosovë, ankuesja pretendon se ka marrë telefonata anonime dhe është shqetësuar në orët e vona kur ishte në shtëpinë e saj. Ajo jeton në shtëpinë e saj me anëtarët e familjes. Ankuesja pretendon se ajo e raportoi rastin në Policinë e Kosovës. Ajo ka vazhduar të kërkojë kujdes mjekësor dhe i ka dorëzuar në Panel dëshmitë të një diagnozë mjekësore të çrregullimit të stresit pas traumatik dhe trajtimit të nevojshëm.

Misioni

25. Si çështje fillestare, Paneli vëren se Misioni nuk duket se kundërshton faktet themelore të ankesës, përkatësisht, se ajo ishte subjekt i kërcënimeve dhe frikësimit siç përshkruhet prej saj, megjithëse tregon për faktin se ankuesja nuk ka arritur të sigurojë prova për thirrjet telefonike kërcënuese të pretenduara.
26. Sidoqoftë, Misioni pohon se ankuesja nuk ishte dhe nuk është dëshmitar i mbrojtur dhe si e tillë, veprimet e Misionit në këtë rast nuk kanë të bëjnë me Programin e tij për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Ky program përmendet si përgjegjës ekzekutiv në dokumentin që formon bazën ligjore për Misionin, d.m.th. Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i 4 shkurtit 2008 i ndryshuar për herë të fundit me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2018/856 të datës 8 qershor 2018.
27. Sa i përket kontekstit të asistencës në këtë rast, Misioni pretendon se ofroi një asistencë të tillë në bazë të një kërkesë të gjykatës në Serbi, dhe në lidhje me përpjekjet e përgjithshme të BE-së për të mbështetur luftën ndaj pandëshkueshmërisë për krime të rënda nën ligjin ndërkombëtar, në përputhje me Kornizën e Politikave të BE-së për Mbështetje të Drejtësisë Tranzicionale.
28. Misioni pretendon se ajo i ofroi ankueses asistencë me udhëtimin e saj në Serbi, dhe se "asistenca për ankuesen ishte e kufizuar në shoqërimin e saj nga adresa e shtëpisë së saj për në [Serbi] dhe përsëri në mënyrë që ajo të dëshmonte vullnetarisht në procedurat penale në vazhdim kundër një numri të të pandehurve".
29. Misioni pohon se e informoi ankuesen se Misioni nuk ishte i përfshirë në proceset në Serbi, dhe se "megjithëse Misioni ishte në gjendje ta shoqëronte atë në ambientet e gjykatës, autoritetet serbe ishin ekskluzivisht përgjegjës për sigurinë e saj gjatë qëndrimit të saj në [Serbi], (përfshirë në ambientet e gjykatës), si dhe në rrugën e saj atje nga Kosova dhe mbrapa".
30. Sa i përket ngjarjeve në gjykatën në Serbi, Misioni pretendon se ishte i pranishëm në galerinë publike nga ku vëzhgoi procedurat gjyqësore. Misioni gjithashtu pretendon se vërejti një shkëmbim të tensionuar midis ankueses dhe të të pandehurve gjatë seancës dëgjimore, dhe një tjetër shkëmbim i tillë kur ankuesja dhe të pandehurit dolën nga salla e gjyqit në të njëjtën kohë.
31. Misioni pretendon se ankuesja nuk u ankua te Misioni për trajtimin e saj në atë kohë. Misioni pretendon se ka realizuar më pas një vizitë për ta parë mirëqenien e ankueses disa ditë pas udhëtimit në Serbi. Në këtë vizitë, sipas Misionit, ankuesja nuk raportoi ndonjë problem, por përkundrazi shprehu mirënjohjen e saj për asistencën e ofruar.
32. Misioni pohon se pretendimi për sa i përket ngjarjeve të ndodhura në Serbi dhe çrregullimit të stresit pas traumatik që është pasojë e drejtpërdrejtë nga të njëjtat ngjarje jashtë territorit të Kosovës është jashtë kompetencave të Panelit qoftë *ratione materiae* ashtu edhe *ratione personae*, dhe për këtë arsye e papranueshme.
33. Sa i përket pretendimit në lidhje me ngjarjet në Kosovë, Misioni pohon se Paneli duhet ta shpall këtë pjesë qartësisht të pabazuar. Misioni pretendon se çrregullimi i stresit pas traumatik i ankueses është jashtë kompetencave të Panelit, si rezultat i drejtpërdrejtë nga ngjarjet jashtë Kosovës, dhe nuk mund t'i atribuohet Misionit. Misioni konsideron se ofroi asistencën më të mirë të mundshme për ankuesen, për t'u kujdesur për mirëqenien e saj në rrethana të vështira, pas pranimit vullnetar nga ana e ankueses të një asistence të tillë.

34. Sa i përket kërcënimeve dhe thirrjeve telefonike anonime, Misioni pohon se ankuesja nuk ofron dëshmi për të vërtetuar pretendimet e saja. Pas pyetjeve në Policinë e Kosovës, Misioni pretendon se nuk ka ndonjë raport penal të parashtruar nga ankuesi për këto ngjarje.

V. VLERSIMI I PANELIT LIDHUR ME PRANUESHËRINË

Paraqitja me kohë e ankesës

35. Paneli vëren se ankuesi paraqiti ankesën e saj brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar, duke respektuar kështu Rregulloren 25(3) të Rregullores së Punës së Panelit. Misioni nuk e kontestoi pranueshmërinë e ankesës në bazë të këtyre arsyeve.

Siguria e dëshmitarëve

36. Paneli vëren, në përgjithësi, se dëshmia e dëshmitarit është shpeshherë thelbësore për ndjekjen e autorëve të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Për të inkurajuar dëshmitarët të japin dëshmi, është thelbësore që autoritetet të marrin masa adekuate për mbrojtjen e tyre (shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, 10 prill 2013, paragrafi 47; Rekomandimi Rec (2005) 9 i Komitetit të Ministrave, Këshilli i Evropës, dhe paragrafët 1 dhe 2 në veçanti, Rekomandimi i referuar gjithashtu në Aktgjykimin e Gjykatës *RR dhe të tjerët kundër Hungarisë*, 4 dhjetor 2012, paragrafi 32; neni 13 i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, në lidhje me dëshmitarët e torturave të pretenduara; neni 12(1) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me forcë, në lidhje me dëshmitarët në rastet e zhdukjes; Neni 18 i Direktivës 2012/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetor 2012 për krijimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit; Rezoluta 60/147 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e datës 16 dhjetor 2005, paragrafi 12(b)).
37. Kriteri për të siguruar mbrojtje është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstet pas konfliktit, siç është Kosova, në të cilën kërcënimi dhe hakmarrja ndaj dëshmitarëve dhe familjeve të tyre janë rreziqe të vërteta. Për më tepër, në raste të tilla, dëshmitarët shpesh janë vetë viktimat, siç është rasti me ankuesen në këtë lëndë, dhe ata mund të vuajnë nga trauma paraprake, e cila me dhënien e dëshmisë mund të përkeqësohet.
38. Misioni pretendon se veprimet e ndërmarra në lidhje me ankuesen nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve. Paneli vëren në këtë kontekst se Misioni dështoi të përgjigjet në disa nga pyetjet e Panelit mbi aktivitetet e mbrojtjes së dëshmitarëve të Misionit. Paneli është në dijeni se informacionet që kanë të bëjnë me programet dhe aktivitetet e mbrojtjes së dëshmitarëve domosdoshmërisht janë shumë konfidenciale. Sidoqoftë, informacione të mëtjetshme mbi aktivitetet e Misionit në këtë fushë mund të ishin të dobishme për analizën e Panelit. Prandaj, Paneli do të përsërisë ato pyetje në këtë vendim dhe fton Misionin t'i adresojë ato me kujdes.
39. Misioni nuk e konteston që ankuesja është dëshmitare në një proces penal. Paneli konstaton që duke propozuar të shoqërojë ankuesen në Serbi, duke ndërmarrë hapa drejt sigurimit të mirëqenies së saj, duke bashkërenduar dukshëm çështjet e sigurisë me autoritetet serbe, dhe duke diskutuar çështjet e sigurisë me ankuesen, Misioni në mënyrë implicite ka pranuar që ekzistonin rreziqe për sigurinë dhe mirëqenien e saj. Në saje të mandatit të tij, Misioni është gjithashtu në dijeni për rreziqe të tilla ndaj dëshmitarëve në procedurat e krimeve të luftës. Në këtë rast të veçantë, Misioni do të ketë qenë në dijeni

të natyrës së rëndë të krimeve të pretenduara që po ndjekëshin penalisht në gjykatë në Serbi, dhe faktin që ankuesja nuk ishte vetëm dëshmitare, por edhe viktimë e të njëjtave ngjarje.

40. Kur Misioni ndërmerr veprime që synojnë sigurimin dhe mirëqenien e një dëshmitari, ai nuk mund të kërkojë të përjashtojë përgjegjësinë e vet ndaj të drejtave të njeriut në bazë të një dallimi – veçanërisht atë që nuk do të ishte e dukshëm nga ata që asistohen - midis një programi formal për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe veprimeve që synojnë të mbrojnë një dëshmitar, por që janë jashtë këtij programi. Këtu, duket se ankuesja kishte përshtypjen se Misioni ishte përgjegjës për sigurinë e saj.
41. Kuadri ligjor i Misionit nuk parasheh dhe nuk autorizon Misionin të sigurojë asistencë dhe mbështetje për dëshmitarët në çështjet penale jashtë mandatit të tij ekzekutiv dhe sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve të përfshirë aty. Kuadri i Politikave të BE-së për Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale, të cilit i referohet Misioni, nuk krijon ndonjë bazë ligjore mbi të cilën Misioni do të merrte autoritetin për ta bërë këtë. Përkundrazi, siç e bën të qartë vetë Dokumenti, është një 'politikë' që përshkruan disa objektiva të caktuara me rëndësi për BE-në. Prandaj, ai nuk krijon një bazë të pavarur juridike mbi të cilën Misioni mund të vepronte jashtë asaj që përcaktohet në Aksionin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP dhe regjimin që rrjedh nga ai.
42. Misioni duket se sugjeron që veprimet e tij përderisa ishte në Serbi, rregulloheshin ekskluzivisht me marrëveshjen që Misioni kishte arritur me autoritetet serbe në lidhje me këtë çështje. Kjo nuk është bindëse.
43. Së pari, autoriteti i Misionit për të hyrë në një marrëveshje të tillë varet nga një bazë valide ligjore që e parasheh atë. Marrëveshjet e palëve të treta nuk krijojnë autoritet ligjor që Misioni të veprojë. Ata thjesht vendosin kornizën dhe kushtet në të cilat ai mund të ushtrojë kompetencën e vet në një kontekst ose rrethanë të veçantë.
44. Së dyti, karakteri i një marrëveshje të tillë dhe mënyra e ekzekutimit të tij gjithnjë duhet të jenë dhe të qëndrojnë në përputhje me autoritetin që Misionit i jepet nga instrumentet e tij themeluese, d.m.th., para së gjithash, nga Veprimi i Përbashkët dhe rregulloret që rrjedhin prej saj.
45. Së treti, fakti që autoritetet serbe kishin përgjegjësi kryesore për sigurinë dhe mirëqenien e ankueses gjatë kohës që ishte në territorin serb nuk do të thotë se përgjegjësia e vetë Misionit ishte larguar. Kjo është e dukshme tashmë nga fakti se Misioni dërgoi stafin e vet për ta shoqëruar atë, se Misioni siguroi një mjek për të dhe se, kur ishte i pakënaqur nga marrëveshjet e akomodimit të bëra për të, Misioni bëri aranzhimet e veta alternative. Se çfarë ishte shkalla e përgjegjësive të tij dhe çfarë mund të bënte në një situatë të caktuar pra nuk është i rëndësishëm për çështjen e pranueshmërisë së kësaj çështje, megjithëse mund të ndikojë në meritat e kësaj lënde.

Ngjarjet në Serbi

46. Paneli më herët ka vërtetuar se nuk ka juridiksion mbi procedurat që zhvillohen jashtë Kosovës (*Familja e z. Dedë Gecaj kundër EULEX-it*, 2011-01, 23 nëntor 2011, paragrafi 53). Sidoqoftë, Paneli është kompetent për të shqyrtuar veprimin e Misionit, në përputhje me mandatin e tij. Paneli vëren se në një lëndë të parashtruar në Paneli, *F dhe të tjerë kundër EULEX-it*, 2011-27, 5 dhjetor 2017, fakti që disa nga ngjarjet e rëndësishme për rastin kishin ndodhur jashtë Kosovës nuk kanë ndikuar në kompetencën e Panelit për të shqyrtuar atë ankesë.

47. Paneli është i mendimit se në atë masë që Misioni kryen aktivitetet e tij jashtë territorit të Kosovës që bien në obligimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut, Paneli është përgjithësisht kompetent për të shqyrtuar atë veprim të tillë. Me vendosjen e një kufizimi në kompetencën e Panelit në një mënyrë të argumentuar nga Misioni, do t'i privonte ankueses mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre dhe një mekanizëm përgjegjës, për të cilin ata mund të ankohen për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut që vijnë nga veprimet e ndërmarra nga Misioni jashtë territorit të Kosovës.
48. Paneli dëshiron të nënvizojë se në rastin konkret, veprimet e Misionit për nga natyra kanë qenë të hartuara si ndërkufitare, dhe kanë të bëjnë me një çështje serioze dhe të rëndësishme - dëshmia e dëshmitares në një proces gjyqësor për krime lufte - e cila është pjesë e konsideratave thelbësore për një mision të sundimit të ligjit në një kontekst pas konfliktit.
49. Për më tepër, Paneli vëren se përfshirja e Misionit duket se e ka inkurajuar ankuesen të pranojë të udhëtojë në Serbi për të dhënë dëshmi. Misioni shoqëroi gjithashtu ankuesen gjatë gjithë qëndrimit të saj në Serbi. Paneli vëren se në një rast të mëparshëm kishte konstatuar se bashkëpunimi i një ankuesi me autoritetet serbe si dëshmitar nuk e kishte shfajësuar Misionin nga përgjegjësitë e veta ndaj ankuesit (*W kundër EULEX-it*, 2011-07, 10 prill 2013, paragrafët 50 dhe 53). Prandaj, Paneli nuk bindet nga pretendimi i Misionit se Panelit i mungon kompetenca në lidhje me ngjarjet në Serbi ose ngjarjet në Kosovë që rrjedhin prej ngjarjeve në Serbi.

Ngjarjet në Kosovë

50. Sa i përket mendimit të Misionit që pretendimi i ankueses për kërcënime dhe thirrje telefonike anonime është i pabazuar, Paneli vëren se parashtresat e palëve, kundërthënëse në çështje të caktuara faktike, nuk e lejojnë Panelin që të hedh poshtë atë pjesë të ankesës si dukshëm të pabazuar. Paneli gjithashtu vëren se procedura përpara Panelit nuk është një proces penal me kritere të domosdoshme për prova. Prandaj është praktikë e Panelit që të mbështetet në deklaratat e ankueses, përveç nëse e vërteta ose saktësia e tyre është duke u kontestuar nga pala tjetër, në këtë rast Paneli angazhohet në një vlerësim të besueshmërisë dhe kredibilitetit të dëshmisë së dhënë bazuar në të gjitha informacionet përkatëse.
51. Paneli gjithashtu i referohet provave të lartpërmendura të çrregullimit të stresit pas traumatik, të paraqitur nga ankuesja, e cila duket se e mbështet deklaratën e saj.
52. Paneli konsideron se, në bazë të parashtresave të palëve, ankesa ngrit çështje faktike dhe juridike, në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës, përcaktimi i të cilave kërkon një shqyrtim të meritave.

PËR KËTO ARSYE PANELI NJËZËRI

SHPALL TË PRANUESHËM ankesën, pa paragjykuar meritat, në lidhje me shkeljet e pretenduara të neneve 3 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

FTON MISIONIN që t'iu përgjigjet pyetjeve të mëposhtme në parashtresat e tij mbi meritat e këtij rasti:

1. Duke përsëritur pyetjen e mëparshme të Panelit, ju lutemi ofroni hollësi për rolin dhe përgjegjësitë e Misionit në mbrojtjen e dëshmitarëve, përtej referencës në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve në Këshillin e Veprimit të Përbashkët 2008/124/CFSP të

datës 4 shkurt 2008, të ndryshuar për herë të fundit me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2018/856 të datës 8 qershor 2018;

2. Duke përsëritur pyetjen e mëparshme të Panelit, ju lutemi sqaroni se si është i angazhuar roli i mbrojtjes së dëshmitarëve të Misionit, dhe nga kush, ose nga cilat autoritete mund të kërkohet që të veprohet;
3. Duke përsëritur pyetjen e mëparshme të Panelit, ju lutemi sqaroni bazën ligjore për Misionin për të zhvilluar aktivitete për mbrojtjen e dëshmitarëve në territorin e Serbisë jashtë kufijve të Kosovës dhe/ose në emër të gjykatave që veprojnë nën autoritetin e Serbisë; Ju lutemi gjithashtu jepni një shpjegim gjithpërfshirës të bazës ligjore në këtë rast të veçantë që Misioni të shoqërojë ankuesen në Serbi për të siguruar dëshminë e dëshmitarit;
4. Ju lutemi sqaroni se cili(cilat) organ(organe) i Misionit ishte përgjegjës për sigurinë e ankueses gjatë kohës sa ishte në Kosovë, dhe nga cila pjesë e Misionit ishin zyrtarët që shoqëronin ankuesin, si dhe kujt i kanë raportuar ata. Ju lutemi sqaroni gjithashtu se çfarë i ka komunikuar Misioni ankueses në lidhje me këtë, kur dhe si. Nëse një entitet tjetër përveç Misionit ishte përgjegjës, ju lutemi jepni prova për marrëveshjen midis Misionit dhe entitetit në fjalë për aranzhimet dhe përgjegjësitë përkatëse;
5. Ju lutemi sqaroni nëse Misioni ka kryer ndonjë vlerësim të rrezikut, duke përfshirë domosdoshmërinë e masave mbrojtëse, në lidhje me sigurinë e ankueses, dhe nëse po, jepni hollësi për vlerësimin, kur është kryer, dhe saktësoni nëse Misioni e ka shpërndarë vlerësimin e tij me ankuesin;
6. Ju lutemi përshkruani llojin e masave mbrojtëse që Misioni konsideron se do të jenë të disponueshme në lidhje me një dëshmitar, i cili është frikësuar për shkak të dëshmisë së tyre në një gjykatë për krime lufte; ju lutemi jepni hollësi edhe për rolin e Misionit në vlerësimin e domosdoshmërisë për masa të tilla dhe për zbatimin e tyre;
7. Ju lutemi i jepni Panelit qasje në komunikimet midis Misionit dhe autoriteteve serbe rreth bashkërendimit, ndarjes së përgjegjësive dhe aranzhimeve praktike, posaçërisht në lidhje me sigurinë, në lidhje me udhëtimin e ankueses në gjykatën në Serbi, duke përfshirë kërkesën nga autoritetet e Serbisë të përmendura në parashtrësit e Misionit;
8. Ju lutemi specifikoni bazën për kërkesën nga autoritetet serbe për asistencën e Misionit, gjegjësisht nëse Korniza e Politikave e BE-së për Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale (2015) ishte baza, dhe nëse Misioni iu bëri të ditur autoriteteve serbe dhe ankueses se Misioni po asistonte mbi këtë bazë kur kishte rënë dakord të ofronte asistencën;
9. Ju lutemi sqaroni procedurën e asistencës juridike të ndërsjellët të përmendur në parashtrësit e Misionit për pranueshmërinë dhe sqaroni rolet përkatëse të (a) Misionit; (b) Zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë; (c) Autoriteteve të Kosovës; dhe (d) Autoriteteve serbe, veçanërisht në lidhje me asistencën dhe sigurinë për dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar përtej kufijve;
10. Ju lutemi sqaroni dallimet ligjore dhe praktike në lidhje me sigurinë dhe asistencën e dëshmitarëve në aktivitetet e Misionit kur ato hyjnë nën (a) Kuadrin e Politikave të BE-së për Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale (2015); dhe (b) Programit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
11. Ju lutemi sqaroni nëse zyrtarët e Misionit inkurajuan apo kërkuan nga ankuesja që të dëshmojë në gjykimin penal; ju lutemi siguroni gjithashtu një kopje të çfarëdo komunikimi të shkruar ndërmjet Misionit dhe ankueses;
12. Ju lutemi specifikoni nëse zyrtarët e Misionit të pranishëm në gjykatën në Serbi diskutuan ngjarjet në gjykatë, veçanërisht kërcënimin e pretenduar, me ankuesen;
13. Ju lutemi sqaroni nëse në pyetjet e saj drejtuar Policisë së Kosovës, Misioni verifikoi të dhënat telefonike të ankueses për të konstatuar nëse ankuesja kishte pranuar thirrjet anonime ose kishte kërkuar nga një palë e tretë të bënte një verifikim të tillë; dhe
14. Ju lutemi sqaroni nëse, gjatë pranisë së tyre në Serbi, stafi i Misionit që shoqëronte ankuesen i ishte nënshtruar autoritetit dhe udhëzimeve të autoriteteve serbe.

FTON ANKUESEN t'iu përgjigjet pyetjeve në vijim:

1. Ju lutemi specifikoni nëse keni vazhduar të merrni kërcënime dhe thirrje telefonike anonime që nga ngjarjet e përshkruara në ankesën tuaj fillestare; nëse po, ofroni hollësi;
2. Ju lutemi specifikoni nëse i keni raportuar këto kërcënime në Mision dhe nëse po, kur dhe kujt;
3. Nëse i keni raportuar këto kërcënime në Mision, ju lutemi specifikoni ato që ju janë thënë nga Misioni;
4. Ju lutemi përshkruani kur dhe si i raportuat kërcënimet dhe thirrjet telefonike anonime në Policinë e Kosovës. Ju lutemi ofroni dëshmi, nëse ka ndonjë, për thirrjet, raportin në Polici dhe secilin hap të ndërmarrë nga Policia e Kosovës; dhe
5. Ju lutemi përshkruani pasojat që frikësimi dhe çrregullimi i stresit pas traumatik kanë pasur mbi ju dhe familjen tuaj.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare